



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13473 Prot

Lezhë, më 29 / 07 /2022

VENDIM

Nr. 89 , Datë 28 . 07 .2022

PËR

**AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË PËR LIDHJEN E KONTATËS SË GRANTIT, ANGAZHIMIN E BURIMEVE FINANCIARE NË PARIM PËR BASHKËFINANCIMIN, MBULIMIN E KOSTOVE TË TVSH-SË DHE MBULIMIN E KOSTOVE TË MIRËMBAJTJES SË INFO POINT-IT PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I TURIZMIT NË LEZHË" NË KUADËR TË THIRRJES "BE PËR BASHKITË", ME REFERENCË APLIKIMI: EU4M-CfP-2-A13.**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ligjin Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 35, datë 21.09.2020 "Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin, dhe publikimin e fondeve më financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", letrën e njoftimit Nr. 157 Prot, datë 25.06.2022 nga "Rrjeti Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës Juglindore" – NALAS, dega Shqipëri për përzgjedhjen e projektit të Bashkisë Lezhë "Zhvillimi i Turizmit në Lezhë" për lidhjen e kontatës së grantit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për lidhjen e kontratës së grantit me Autoritetin Kontraktor "Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës Juglindore" – NALAS, dega Shqipëri, në kuadër të thirrje për propozime Skema e Granteve "BE për Bashkitë" (EU4M) që financohet nga Bashkimi Evropian.
2. Të miratojë në parim angazhimin e burimeve financiare për bashkëfinancimin në vlerën 5,184 Euro dhe në vlerën 9,328 Euro për pagesën e TVSH-së në buxhetin vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm.
3. Të miratojë në parim angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes për "info point-in" pas përfundimit të projektit "Zhvillimi i Turizmit në Lezhë".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 13173/1 Prot  
Dt 08.08.2022

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 549/4 Prot.

Lezhë, më 04.08.2022

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16, pika 2, germa “b“, të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, dhe në ligjin nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore“, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 89 datë 28.07.2022 të këshillit të bashkisë Lezhë “Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Lezhë për lidhjen e kontratës së grantit, angazhimin e burimeve financiare në parim për bashkëfinancimin, mbulimin e kostove të TVSH-së dhe mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së INFO POINT-it për projektin “Zhvillimi i Turizmit në Lezhë“ në kuadër të thirrjes “BE për Bashkitë“, me referencë aplikimi: EU4M-CfP-2-A13“.

PREFEKTI  
Gjergj PRENDI